

Amt für Volksschulbildung

Si mund ta ndihmoj unë fëmijën tim në moshën prej 4 deri 8 vjeçare në mësimin e matematikës – Albanisch

Të menduarit matematik sikurse edhe mësimi i të folurit e i të ecurit është pjesë e zhvillimit fëmijor. Aftësitë matematike janë njohja e sasive, njohja e formave, vetëorientimi në hapësirë, perceptimi i vetëdijshëm i mjedisit dhe i veprimeve, të vepruarit me numrat dhe format. Ju si prindër e përkrahni fëmijën tuaj në rrugën e matematikës, nëse ju i merrni seriozisht pyetjet e tij, zhvilloni biseda me fëmijën dhe e nxitni për vetëveprim.

Fëmija mëson në situatat e jetës së përditshme veprime të ndryshme matematike

Aktivizojeni fëmijën tuaj me vetëdije në veprimtaritë e jetës së përditshme:

- Lëreni të shtrojë tavolinën. Jemi 6 persona që do të ulemi për të ngrënë. Piceta duhet të paloset – nga katërkëndëshi formohet një trekëndësh.
- Gatواني me fëmijën dhe flisni rreth kësaj: Na duhen 4 vezë, 200 g sheqer, 1 lugë kripë.
- Lëreni të ndajë një domate në dy gjysma, pastaj secilën gjysmë ta ndajë përsëri në dy gjysma, lëreni të presë një salçiçe në rriska, të mbushë një gotë qumësht etj. Të hiqet dhe të shtohet diçka janë veprime të rëndësishme për të kuptuarin e llogaritjeve me plus dhe minus.
- Gjatë blerjes lëreni të paguajë shumën të vogla.
- Lëreni të formojë numra të telefonit.
- Në festat e ditëlindjeve flisni mbi moshat e ndryshme të fëmijëve.
- Fëmijët të nxitin në veprime si p.sh. të ndajnë drejtë një dorë plot me rrush të thatë, një kaush me kikirikë ose një çokollatë në formë zemre.

Fëmija pyet për sasinë, madhësinë dhe intervalet kohore

Kërkoni së bashku të gjeni një përgjigje ose drejtoni ju vetë pyetje të tilla:

- Sa gurë janë këtu? Sa yje janë në qiell? Sa cornflakes ka në kuti?
- Sa e lartë është kjo pemë? Sa peshon ti? Sa ujë zë vaska e banjës?
- Sa vjeçare është kjo pemë? Edhe sa kohë ka mbetur deri në ditëlindjen time?

Fëmija numëron

Shfrytëzoni përherë rastet kur paraqiten numrat:

- Kemi vizitë – sa persona?
- Sa dritare ka kjo ndërtesë?
- Numëroni guaskat e mbledhura.

Fëmija tregon histori, barcala, ngjarje

Për këtë fëmija duhet të mund të përfytyrojë rrjedhën e ndodhive, kjo është një veprimtari e rëndësishme matematike.

Gjatë punëve me dorë fëmija kupton format

Këtu flisni për veprimet dhe format që dalin gjatë prerjes, palosjes, ngjitjes:

- Duke e palosur katrorin formojmë një trekëndësh.
- Për çatinë e kullës presim më parë një rreth.

Fëmija ndërton dhe konstrukton i lirë me kuba ndërtimi, lego, shina të trenit

Për këtë vëni fëmijës vend në dispozicion. Lëreni fëmijën të ndërtojë me plan mjete udhëtimi, ndërtesa.

Fëmija mëson të njohë vëllimet e hapësirave

Lëreni fëmijën të merret me ujë, të gërmojë liqene në vendin e rërës, të ndërtojë kanale (kjo mund të bëhet edhe me tubat e hollë të pirjes) dhe të mbushë enë.

Fëmija vetëorientohet në hapësira të mëdha

Kur jeni jashtë me fëmijën tuaj në këmbë ose me biçikletë, flisni rreth kësaj, ku, çfarë dhe në cilin drejtim është:

- Ku është shtëpia e jonë?/Po ku është stacioni i trenit?
- A e di ti se në çfarë drejtimi është qyteti? Pas një shëtitje kërkoni rrugën në hartë. Shihni planin e komunës tuaj.

Fëmija nuk duhet të mësojë të llogarisë përmendësh. I nevojshëm është një përfytyrim i numrave dhe veprimeve matematike. Për një kuptim më të mirë ndihmojnë zakonisht konkretizimet me sende, riprodhimi i situatave dhe biseda rreth asaj që bëhet.